



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1842/4 Prot

Tiranë, më 23.12.2022

VENDIM

Nr.64, datë 23.12.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, (në vijim “ankuesja”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesat nr. 1841 Prot., dhe nr. 1842 Prot., datë 26.10.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në përputhje me shkronjën “ç” të nenit 65 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duke qenë se ankesat lidhen me të njëjtat fakte, bazë ligjore dhe i drejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon trajtimin e tyre në një vendim të vetëm.

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 04.10.2022, depozituar në adresën elektronike enxhi.toska@infrastruktura.gov.al, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion relacionet përfundimtare të VKM - ve të miratuara gjatë katër – mujorit të parë të vitit 2022, me propozim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si vijon:

1. Nr. 1, datë 10.1.2022 “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Grupit Jones International, për forcimin e sigurisë kibernetike të infrastrukturës kritike për Shqipërinë”;

2. Nr. 21, datë 13.1.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i fushës sportive Laprakë”, Tiranë”;
3. Nr. 22, datë 13.1.2022 “Për përcaktimin e kategorive të ndërtesave, që përjashtohen nga detyrimi i pikës së aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike”;
4. Nr. 37, datë 19.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), dhe KfW Frankfurt Am Main (KfW), për programin “Promovimi i energjive të rinovueshme dhe eficiencës”;
5. Nr. 38, datë 19.1.2022 “Për miratimin e marrëveshjes së projektit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për çështjet ekonomike, mbi dhënien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e “Projektit të bashkive me energji inteligjente (SEMP)””;
6. Nr. 39, datë 19.1.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, mbi njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit me qëllim konvertimi, miratuar me vendimin nr.209, datë 29.3.2021, të Këshillit të Ministrave”;
7. Nr. 75, datë 2.2.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës “Jakov Mile”, segmenti II, lagjja “Apolonia”, Fier”;
8. Nr. 95, datë 9.2.2022 “Për miratimin e Programit Shtetëror të Sigurisë në Operim në Aviacionin Civil”;
9. Nr. 96, datë 9.2.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i parkimit publik, lulishte e ndriçim”, Bashkia Cërrrik”;
10. Nr. 104, datë 16.2.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave të qytetit Kavajë””;
11. Nr. 105, datë 16.2.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, prone private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i lulishtes panoramike pranë lumit Devoll, blloku nr.1, qyteti Maliq””;
12. Nr. 125, datë 2.3.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;
13. Nr. 134, datë 2.3.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 577, datë 3.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga ndërtimi i objektit “Rikonstruksioni i Rrugës “Mujo Ulqinaku” (Seg. i Dytë) dhe Rrugës “Jakov Mile”, Fier”, të ndryshuar””;

14. Nr. 155, datë 11.3.2022 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë”;
15. Nr. 189, datë 30.3.2022 “Për përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina”;
16. Nr. 190, datë 30.3.2022 “Për miratimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile”;
17. Nr. 191, datë 30.3.22 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Natyral Energy System”, sh.p.k.”;
18. Nr. 206, datë 6.4.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, nyja e Milotit””;
19. Nr. 207, datë 6.4.2022 “Për miratimin e dokumentit të politikës së shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, 2021 e në vijim”;
20. Nr. 219, datë 13.4.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, prone private, që preket nga projekti “Zgjerimi i varrezave Moravë, njësia administrative Otllak, Berat””;
21. Nr. 220, datë 13.4.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim i lagjes “29 Marsi”, blloku “Zjarrfikësja”, Patos””;
22. Nr. 221, datë 13.4.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 795, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (lotet I, II)”, të ndryshuar”
23. Nr. 222, datë 13.4.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga projekti “Zgjerimi i sipërfaqeve të varrezave publike Tufinë, faza 2””;
24. Nr. 224, datë 13.4.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor””;
25. Nr. 225, datë 13.4.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë”;
26. Nr. 244, datë 20.4.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga projekti “Ndërtim kopshti dhe çerdhe e integruar nr.42””;
27. Nr. 256, datë 29.4.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike””;

28. Nr. 278, datë 29.4.22 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Sistemim rrugësh, blloku “Përroi i Çaprazit”, Pogradec””;
29. Nr. 279, datë 29.4.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.658, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik-Unaza e Madhe e Tiranës)”, të ndryshuar”;

Ndërkohë, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 10.10.2022, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion relacionet përfundimtare të Vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara gjatë periudhës Maj – Shtator 2022, me propozim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si vijon:

1. Nr. 299, datë 11.5.2022 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e “Portit të integruar” në Triport Vlorë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Agbes Construcion” sh.p.k., “Besta” sh.p.k., “Premium Construction & Maintenance” sh.p.k., “ITE Grup” sh.p.k. dhe “Arkonstudio” sh.p.k.”;
2. Nr. 300, datë 11.5.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Sistemim rrugësh, blloku te stadiumi”, Pogradec”;
3. Nr. 301, datë 11.5.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit”;
4. Nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;
5. Nr. 329, datë 18.5.2022 “Për një shtesë në vendimin nr.656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar”;
6. Nr. 357, datë 26.5.2022 “Për përcaktimin e kritereve dhe të rregullave të transferimit të të drejtave minerare nga zotëruesi”;
7. Nr. 360, datë 26.5.2022 “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe shoqërisë “Gener 2” sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “G2 Infra” sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e aksit rrugor Thumanë–Vorë–Kashar”;
8. Nr. 361, datë 26.5.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Sistemim-asfaltim i rrugës ‘Fuat Toptani’””;
9. Nr. 377, datë 1.6.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 228, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të

- pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë– Elbasan”, të ndryshuar”;*
10. Nr. 378, datë 1.6.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 545, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë – Elbasan””;
 11. Nr. 379, datë 1.6.2022 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Bashkia Tiranë tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të pasurisë me sipërfaqe 247 m², me numër 12/325, në zonën kadastrale 8310, Tiranë”;
 12. Nr. 380, datë 1.6.2022 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2022–2024, në zbatim të strategjisë minerare”;
 13. Nr. 397, datë 9.6.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i segmentit të kryqëzimit ish-kombinati ‘Josif Pashko’ – ish-Uzina ‘Dinamo e Re’””;
 14. Nr. 398, datë 9.6.2022 “Për trajtimin e disbalancave të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike”;
 15. Nr. 399, datë 9.6.2022 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike “Erseka Solar Park 2” dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading Co” sh.p.k”;
 16. Nr. 400, datë 9.6.2022 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike “Erseka Solar Park 1” dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading Co” sh.p.k”;
 17. Nr. 401, datë 9.6.2022 “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Frakull, në Shqipëri, ndërmjet “Albpetrol” sh.a. dhe “EDG Natural Gas” sh.p.k”;
 18. Nr. 402, datë 9.6.2022 “Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Povelçë, në Shqipëri, ndërmjet “Albpetrol” sh.a. dhe “EDG Natural Gas” sh.p.k”;
 19. Nr. 416, datë 15.6.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim Krujë, Bashkia Krujë”;
 20. Nr. 417, datë 15.6.2022 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr.3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit, nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k”;
 21. Nr. 454, datë 29.6.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 594, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të

- pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1, shtesat, pjesa lindore', Vlorë", të ndryshuar";*
22. Nr. 455, datë 29.6.2022 *"Për disa ndryshime në vendimin nr.28, datë 17.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar", të ndryshuar";*
23. Nr. 456, datë 29.6.2022 *"Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike";*
24. Nr. 457, datë 29.6.2022 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar";*
25. Nr. 478, datë 13.7.2022 *"Për disa ndryshime në vendimin nr.906, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale nr.8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën e ish-Kënetës, Spitallë";*
26. Nr. 498, datë 29.7.2022 *"Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e sektorit energjitik";*
27. Nr. 510, datë 27.7.2022 *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Projektimi i Shkollës së Bicikletave për grupmoshat 7 - 10 vjeç, Tiranë";*
28. Nr. 546, datë 29.7.2022 *"Për lirim dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin";*
29. Nr. 547, datë 29.7.2022 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.354, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës "Porti i Jahteve - By-Pass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)";*
30. Nr. 564, datë 29.7.2022 *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit arkitektonik "Mozaiku i Tiranës";*
31. Nr. 567, datë 25.8.22 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.794 datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Ndërtimi i segmentit rrugor, "Rruga e Arbrit";*
32. Nr. 568, datë 25.8.2022 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.657, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës - Pogradec – Qafë Plloçë";*
33. Nr. 569, datë 25.8.2022 *"Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e transportit të linjave qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë, faza II";*

34. Nr. 576, datë 31.8.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike, Elbasan””;
35. Nr. 577, datë 31.8.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës Pogradec – Tushemisht – Doganë””;
36. Nr. 587, datë 7.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i hidrocentralit “Grabova 2” mbi pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, në qarkun Elbasan””;
37. Nr. 588, datë 7.9.2022 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Sistemimi i hapësirave publike dhe parkim, lagjja e re, Blloku pas ish-Bashkisë Patos””;
38. Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”;
39. Nr. 597, datë 14.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës”;
40. Nr. 589, datë 14.9.2022 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative Vorë, Bashkia Vorë, faza II”;
41. Nr. 603, datë 14.9.2022 “Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e sektorit energjetik, faza II”;
42. Nr. 609, datë 22.9.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, “Skelë – Uji i Ftohtë”, Bashkia Vlorë”, të ndryshuar”;
43. Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Autoriteti Publik, lidhur me kërkesën e parë për informacion, nëpërmjet e-mail-it datë 21.10.2022, ka kthyer përgjigje duke cituar ndër të tjera se: “Në zbatim të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, përcaktohet se, projektaktet së bashku me relacionin shoqërues depozitohen në Këshillin e Ministrave për miratim. Për sa më sipër, lidhur me këtë kërkesë sugjerojmë t'i drejtoheni Kryeministrisë”.

Ndërkohë, lidhur me kërkesën e dytë Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje.

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik lidhur me kërkesën e parë për informacion, ankuesja pretendon se: *“...Pretendimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përbën një shkelje të dyfishtë për ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si në aspektin e refuzimit të vënies në dispozicion të dokumentacionit zyrtar që autoriteti e disponon vetë, ashtu edhe në mosdërgimin e kërkesës në autoritetin përgjegjës, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Kodit të Procedurave Administrative në rastin kur faktikisht nuk e disponon dokumentacionin.*

Relacioni është një dokument zyrtar që shoqëron projekt VKM-në. Si i tillë, ai mban stemën e institucionit propozues dhe nënshkrimin e drejtuesit të tij. Mes të tjerash, në të përfshihen mendimet dhe vërejtjet institucionale të ministrive dhe institucioneve të interesuara, si edhe shpjegimet për marrjen ose jo parasysh të tyre. Dokumentet zyrtare u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që përcaktohen specifikisht në ligjin për të drejtën e informimit ose në ligje të tjera të posaçme. Relacioni shoqëruar i projekt VKM-së nuk rezulton të jetë subjekt i asnjë kufizimi.

Rrjedhimisht, relacioni përfundimtar që shoqëron projekt VKM-në, si një dokument zyrtar, që nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi ligjor, përbën një informacion publik, i cili duhet vënë në dispozicion sipas kërkesës për informim në ushtrim të një të drejte kushtetuese. Refuzimi për vënien në dispozicion të këtij informacioni është një akt i paligjshëm, i cili shkel të drejtën kushtetuese për informim të çdo qytetari.”

Në vijim, ankuesja kërkon nga Zyra e Komisionerit, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të cituar si më sipër.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresat nr. 1841/1 prot., dhe nr. 1842/1 Prot., datë 02.11.2022 kërkoj nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 18.11.2022, ka kthyer përgjigje duke refuzuar vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar me argumentin se: *“...Në përputhje me nenet 24 dhe 25 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ministritë e linjës hartojnë relacionin shpjegues për projektaktin, i cili ndër të tjera përmban shpjegimin për marrjen ose jo parasysh të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrive ose të institucioneve të tjera të interesuara. Sipas nenit 16, të ligjit nr. 9000/2003, gjatë mbledhjes së Këshillit të Ministrave, ministrat*

kanë të drejtë të shfaqin mendimin e tyre mbi projektaktet që janë dërguar paraprakisht për mendim, sipas nenit 24 të ligjit. Më tej, pika 62 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, parashikon se: ‘Drejtuesi i mbledhjes paraqet thelbin e projektaktit, i kërkon ministrit propozues, nëse ka komente lidhur me propozimin e tij dhe më pas fton anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave për të shprehur mendimin e tyre’.

Sipas nenit 17, të ligjit 9000/2003, çdo anëtar i Këshillit të Ministrave është i detyruar të respektojë vendimet e marra në mbledhjet e Këshillit të Ministrave dhe çdo vlerësim, debat apo raportim duhet të mbetet konfidenciale.

Në këtë kuptim, mendimi i dhënë nga çdo anëtar i Këshillit të Ministrave, është pjesë e pandashme e procesit të shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve dhe është baza e diskutimeve, vlerësimeve dhe debateve në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

Gjatë kësaj mbledhje ministrat e linjës shprehen duke u bazuar në mendimin që kanë dhënë paraprakisht mbi projektvendimin gjatë procesit të hartimit dhe bashkërendimit të projektakteve.

Pra, mendimet që japin ministrat e linjës për projektaktin, si dhe shpjegimi që ministri i linjës jep në relacionin shpjegues të çdo projektakti, për marrjen ose jo parasysh të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrave të ministrave ose institucioneve të tjera të interesuara, është pjesë e provës vendimarrës të Këshillit të Ministrave, i cili nuk mund të bëhet publik për shkak të kufizimeve të vendosura në nenin 17, të ligjit 9000/2003. Në përputhje me këtë dispozitë, mendimet e dhëna nga ministrat e linjës dhe shpjegimet e dhëna nga ministrat e linjës për marrjen ose jo parasysh të tyre, janë pjesë e pandashme e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit të çdo mbledhjeje të Këshillit të Ministrave. Rrjedhimisht, ky detyrim, i lexuar bashkërisht me kufizimet e përcaktuara nga neni 17 i LDI, na përjashton nga detyrimi për t’ju vendosur në dispozicion relacionet që keni kërkuar”.

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* si edhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 1842/3 Prot., datë 02.12.2022, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seancë e cila u zhvillua me datë 07.12.2022, me prezencën e përfaqësuesve të Autoritetit Publik, të cilët rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur, dhe në mungesë të ankueses, e cila me e-mail-in datë 07.12.2022, bëri me dije mbi pamundësinë për pjesëmarrje fizike të saj. Ankuesja gjithashtu sipas kërkesës së Zyrës së Komisionerit, vendosi në dispozicion parashtrimet me shkrim mbi të cilat i qëndron ankesës dhe mbështet vijimin e ankimit.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se argumentet e dhëna nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse,*

gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj". Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Ndërkohë, në nenin 1 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të ministrit, të institucioneve në varësi të tyre, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet nënligjore, që nxjerrin këto organe"*.

Gjithashtu, vendimi nr. 584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e rregullore së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar, në Kreun I, parashikon se: *"Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me: a) përgatitjen dhe paraqitjen e projektakteve, si dhe shqyrtimin e tyre në Këshillin e Ministrave; b) organizimin e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave..."*.

Në këto kushte, neni 17 i ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", i cituar nga Autoriteti Publik, i cili parashikon se: *"1. Anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet t'i respektojnë vendimet e marra në mbledhjet e Këshillit të Ministrave. Ata duhet të mënjanojnë në mënyrë të veçantë çdo shprehje mospajtimi dhe të mbrojnë ose të përkrahin vendimet e lartpërmendura, pavarësisht nga fakti nëse kanë marrë pjesë ose jo në mbledhje, ose nëse kanë votuar pro ose kundër tyre. 2. Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten konfidenciale"*, i referohet konkretisht organizimit dhe funksionimit të mbledhjeve të anëtarëve të Këshillit të Ministrave, lidhur me diskutimet/vlerësimet dhe jo akteve të cilat prodhohen/përpilohen nga autoritetet publike në kuadër të detyrës së tyre funksionale.

Në pikën 1 të nenit 25 të ligjit të sipërcituar parashikohet se: *"1. Propozimet e projektakteve, që paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, duhet të përmbajnë projektaktin, relacionin, mendimet ose vërejtjet e ministrive ose të institucioneve të interesuara..."*.

Gjithashtu, në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e rregullore së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar, në Kreun VI "Paraqitja e projektakteve për shqyrtim në Këshillin e Ministrave", parashikohet se: *43. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. 44. Projektakti, relacioni shpjegues, dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të kësaj rregulloreje, në dy kopje origjinale, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave. 45. Propozimet e projekteve shoqërohen me: a) projektaktin e bashkërenduar me ministritë përkatëse; b) relacionin shpjegues, i cili përveç të dhënave të parashikuara në pikat 19 dhe 20 të kreut të katërt të*

kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë edhe shpjegime për arsyet e mosreflektimit të vërejtjeve ose sugjerimeve të bëra nga ministrinë e interesuara; c) mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara. Në çdo rast mendimi i Ministrisë të Drejtësisë duhet të shoqërojë projektaktin; ç) tekstin e plotë të traktatit a marrëveshjeve ndërkombëtare, në gjuhë të huaj dhe në shqip, të vërtetuar zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, kur projektakti ka këtë objekt.”

Rrjedhimisht, referuar dispozitave të sipërcituara, këto akte, të cilat përpilohen/regjistrohen pranë Autoritetit Publik dhe janë pjesë detyruese që shoqërojnë projektaktin përkatës, përbëjnë informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Por, edhe nëse ky dokumentacion publik do të kishte aspekte konfidenciale, ashtu si pretendon Autoriteti Publik, në frymën e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*, ai duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tij.

Konstatohet gjithashtu se, Autoriteti Publik në asnjë moment nuk ka argumentuar apo cituar se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar. Pasi, është ky nen i cili parashikon mundësinë e kufizimit e të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Theksojmë se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesave nr. 1841 Prot., dhe nr. 1842 Prot datë 26.10.2022 të znj.
, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, me objekt
“*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas
kërkesave për informacion datë 04.10.2022 dhe 10.10.2022, duke respektuar
kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e
informimit”, brenda datës 06.01.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative
Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për
të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 23.12.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi